Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 01 Nr. 16828
Br.
Nr. i faq. 1 Data: 23/05
Br. str. Datum:
KAMENICË/A 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal i Kamenicës**
**Datë: 23.05.2024**

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 23.05.2024 :

**T H Ë R R E T**

Mbledhjen e V-të (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: **30.05.2024**, duke filluar nga ora **10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.
Për mbledhje propozoj këtë,

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 4-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024.

2. Pyetje legjislativit drejtuar ekzekutivit.

3. Plani i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali (2024-2026) në Komunën e Kamenicës.

4. Draft-Plani i Veprimit për Mekanizmin Koordinues Kundër Dhunës në Komunën e Kamenicës (2024-2026)

5. Të ndryshme.

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 16833
Nr. i faq. Br. str. 13 Data: Datum: 23/05
KAMENICË/A 2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IV-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës e mbajtur më: 29.04.2024 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit, përfaqësues të Zyër për Integrime Evropiane dhe OJQ. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 3-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024,
2. Pyetje e legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Kompaninë " Waste to hydrogen L.L.C" me procedurë të negocimit të ofertës,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar Janar-Mars 2024,
5. Propozim-Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankdandit publik,
6. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankandit publik,
7. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024,
8. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit në pronën e paluajtshme të Komunës së Kamenicës për ndërtimin e Strehimorës për Qentë endacak,
9. Propozim për plotësim ndryshimin e vendimit nr.15617 i datës:08.06.2021,
10. Propozim-Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankandit publik,
11. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankandit publik,
12. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, para se me filluar konstatojmë se kemi kourum të mjaftueshëm për të filluar seancën, a keni propozime për plotësim-ndryshim të rendit të ditës?

**Kadri Rahimaj-Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës**, kemi një propozim-vendim për hartimin e hatër zonale, komuna e Kamneicës është në proces të përfundimit të PZHK-së, drafti për PZHK-në është duke u shqyrtuar nga ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës, pas PZHK-së dokumenti tjetër i rëndësishëm që duhet të i bashkangjitet edhe dokumenteve të planifikimit urban dhe hartat zonale që përcakton kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonar urbane dhe rurale me këtë kontekst të ndryshimeve të bëra dhe në harmonizim dhe për të arritur kushtet optimale të rregullimit dhe ndërtimit në komunën e Kamenicës, prandaj kërkoj që ky propozim të jetë pjesë e rendit të ditës.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**, hedhim në votim propozimin ?
**Kush është për miratiminin e këtij propozimi?**
**Për.........................të gjithë**
**Kundër ..................0**
**Absntenim...............0**

**Rabit Dërmaku**, rendi i ditës që ishte në KPF ishin vetëm tri pika të rendit ditës, ndërsa tani në kuvend i kemi edhe shumë pika të tjera, dua njq sqarim nga ju në mënyrë që të dijë se çka bënë Komiteti për Politikë dhe Financa ?
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**- do të jap sqarim pasi që kalojmë rendin e ditës. Kush është për miratimin e rendit të ditës me ndryshimet e bëra?
**Për.........................të gjithë**
**Kundër ..................0**
**Absntenim...............0**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-propozimet që vinë nga ekzekutivi kanë pasur një vonesë pasi që shumica e drejtorëve ishin në vizitë zyrtare dhe propozimet që vinë nga ekzekutivi kanë pasur një vonesë. Por nga 9 pika në rend dite i kemi shqyrtuar në KPF dhe janë dëshmitar anëtarët e KPF-së, por për KPF nuk kemi arritur që t'i përgadisim por në KPF të gjitha ishin të gatshme dhe kanë marrë trajtimin e duhur.
**Rabit Dërmaku**- unë po pyes se a janë diskutuar këto pika në KPF se unë kam rendin e ditës vetëm me tri pika?
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**- pikat tjera janë trajtuar gjatë mbajtjes në mbledhje të KPF-së
**Rabit Dërmaku**- unë për atë pyeta se nuk është hera parë që sjellën edhe shumë pika për rend dite.

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e 3-të e Kuvendit Komunal për vitin 2024**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-a keni vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk kemi vazhdojmë me procedurën e votimit të procesverbalit?
**Kush është për miratimin e procesverbalit?**
**Për.........................të gjithë**
**Kundër ..................0**
**Absntenim...............0**

2. **Pyetjet e legjislativit drejtuar ekzekutivit**

**Egzona Isufi**-pyetja e parë është për drunjët dekorativ që mbi gjysma po rezultojshin si të thara, a janë duke u mirambajtur, ngase ka qenë një kosto e madhe për ta? Pyetja e dytë është që gjatë fushatës keni folur për një kuzhinë qendrore, a është duke u punuar diçka rreth saj?

**Ramadan Basha**-po du me ngrit një shqetësim rreth mirëmbajtjes së aseteve të ujësjellësve të komunës tonë, kam parë një pjesë e madhe e hapësirat e rezervarëve nuk mirëmbahen nga Hidromorava. Hidromorava ka filluar edhe me do drunj që mund të dëmtojnë strkturën e rezervarëve, jam i vetëdijshëm që nuk është kompetencë e komunës, por mendoj që komuan duhet të ushtrojë presion me qëllim që të minrëmbahen këto hapësira dhe t ëmos dëmtohen strukturat e rezervarëve. Hapësirat e rezervarëve të bazenave nuk mirëmbahen mirë nëse vazhdohet edhe për një periudhë kohore jam i bindur që strukturat e rezervarëve të bazeneve mund të na shkaktojnë dëm dhe mund të pengohet edhe furnizimi i qytetarëve me ujë, ju rekomandojë që të ushtrohet presion tek hidromorava që këto hapësira të mirëmbahen.

**Sejdi Kurteshi**-pyetja jem është për sheshin çka po ndodh që punët nuk po kryhen, kanalizimi në Koretin vetëm se iku dhe a keni ndonjë projekt që e keni kryer? Shkolla "Fan S. Noli", ka mbetur në gjysmë, nxënësi i keni dërguar 1 muaj pa e përfunduar vitin tek " Dëshmorët e Kombit" se është dahsru të pritet të paktën renovimi të bëhej gjatë pushimit veror.

**Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës**, sa i përket pyetjes së znj, Egzona është e vërtet që disa drunj dekorativ nuk kanë zënë, ne kemi themeluar një komision që i ka verifikuar drunjtë e sukseshëm dhe drunjt e pasuksesshëm, kontrata është brenda afatit të sigurimit dhe kemi ëkrkuar që kompania të bëjë zëvendësimin e drunjëve dhe kjo nuk do të ketë kosto shtesë për komunën. Ne kemi ndarë fond për ndërtimin e kuzhinës qendrore, si asambleiste do duhej me ditë se çka voton ky kuvend, ne kemi hartuar edhe projektin dhe mendojmë se kuzhina qendrore do të jetë në fshatin Dajkovc dhe shumë shpejt do të fillojnë procedurat e prokurimit publik. Falënderoj z. Basha për rekomandimin për mirëmbajtjen e pusetave dhe rezervarëve gjë që do të kërkojmë nga drejtoria e shërbimeve publike t'i shkruaj zyrtarisht " Hidromoravës" sa i përkte z. Kurteshit, është e vërtet që bulevardi është duke pasur vështirësi në implementin dhe përmbushje të kontratës. Kontratën e parë ne vetëm se e patëm vazhduar ngase e kemi gjetur me 10% të punëve të kryera në atë kohë, tani pjesa më e madhe e bulevardit është funskional, kompania e parë ka qenë shumë e paërgjegjshme ne e kemi shfrytëzuar infrastrukturën ligjore ku kemi gjobitur kompaninë e parë mbi 70 mijë euro dhe shuëm shpejt presim edhe konfiskimin e sigurimit që ka vlerën mbi 90 mijë euro kemi lidhur kontratën e dytë me një operator të ri ekonomik i cili po ashut ka vështirësi sa i përket tullës klinker e cila gjendet vështirë në treg por është edhe sasi e vogël që operatorët ose prodhuesit nuk kanë interes me bashkëpunuar me këto raste. Në Koretin është hera e dytë që na tentojmë me e zgjidh problemin e kalnalizimit por ka pengesa nga qytetarët pasi ne kemi filluar punën por disa qytetarë vetëm se pengojnë punën për implementimin e këtij projekti për arsye të komshiut, ndërsa do të zhvendosim kompaninë për reahvbilitimin e kolektorit që është dëmtuar nga cilësia e dobët e punimeve të mëhershme. Sa i përket nxënësve ne kemi filluar renovimin e brendshëm të Gjimnazit " Ismalj Qemajli" që ka vlerë mbi 350 mijë euro, shkolla do të jetë një prej objekteve më të mira në Kosovë, ato që kemi përfunduar është vet gjimnazi renovimin e jashtëm vlerë mbi 200 mijë euro. Ka shumë projekte që kanë përfunduar si qerdhja, Qendra për Punë Sociale, shkolla " Metush Krasniqi", renovimi i bredshëm i shkollës në Hogosht, janë mbi 20 rrugë të përfunduara, ka shumë kanalizime, ka qindra shtëpi të lidhura në rrjetin e ujësjellësit ato që

ne i kemi përfunduar mund të merrni pjesë në dëgjime publike për t'i parë se cilat janë ato projekte.

**Sejdi Kurteshi**-pse nuk përfundon sheshi, pse është bllokuar puna aty?

**Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës-** prej 10% të punëve që kemi gjetur në teren 140 mijë ka qenë pagesat,ne kemi bërë 511 mijë euro pagesa, maksimumin e pagesave.

**3. Propozim-Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për Kompaninë "Waste to hydrogen Kosova L.L.C" me procedurë të negocimit të ofertës,**

**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor**, bqhet fjalë për Kompaninë **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"** me numër të biznesit 812038439 me përfaqësues z. Adnan Hoxha, ku kanë paraqitur kërkesën për marrjen e pronës komunale në shfrytëzim për zhvillimin e projetit të prodhimit të energjisë së rinovueshme në formë të Hidrogjenit të pastër objekt i negocimit ka qenë zona kadastrale Topanicë, sipërfaqja 42 mijë metra katror. Afati i dhënies me qera të pronës komunale është 35 vite me mundësi vazhdimi nëse nuk bie ndesh me ligjet e tanishme dhe të reja që mund të vinë si dhe përmbushja e planit të biznesit. Qëllimi i dhënies së pronës për subjekti në fjalë është për projektin zhvillimi i impiantit prodhim i energjisë së renovueshme në formë të hidrogjenit të pastër me kapacitet dhe aktivitete si në projektin e propozuar. **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"** me emër të kompenzimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguajë komunës qira vjetore në vlerë prej 12 mijë euro në vit nga subjekti **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"**, por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregulloren komunale. Vlera e investimit do të jetë 18 milion euro sipas planit dinamik dhe zhvillimor financiar. Për të siguruar iunvestimin në realizimin e planit investues kjo kompani detyrohet të ofrojë një polis të sigurimit apo garancion bankar në vlerë prej 100 mijë euro e cila do të shërbejë në rast të dështimit të investitorit. **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"**, raporton te komuna e Kamenicës çdo gjashtë muaj mbi implementimin e projektit dhe vlerën e investimit, po ashtu duhet të përfundojë investimet sipas planit të biznesit të cilin e ka dorëzuar pasi prona të kalojë në pronësi të të investitorit afati për pajisje me leje ndërtimore është 12 muaj. Dështimi me lje brenda afatit nënkupton shkëputje të njëanshme me marrëveshje nga komuna dhe konfiskim të sigurimit. Numri minimal i punëtorit nuk guxon të bie më poshtë se 20 punëtorë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik, pa koordinim dhe pajtim me komunën prej momentit që kompania fillon punën me kapacitet të plotë. Kompania obligohet që të punësojë persona me aftësi të kufizuar, kompania obligohet të bashkëpunojë dhe mbështesë financiarisht organizatën " Handikos", në komunën e Kamenicës përmes një memorandumi të bashkëpunimit. Kompania obligohet të bashkëpunojë me DKA-në, përkatësisht me shkollën profesionale për angazhimin e praktikantëve me pagesë me projektet e tjera që mund të propozohen nga DKA. Do të synohet që maksimalisht punëmarrësit të jenë të komunës së Kamenicës, burimet natyrore si psh burimet e ujit nuk i takojnë shfrytëzuesit të tokës komunale përveq për përdorim brenda kompleksit të ndërtuar. Banorët përrreth që shfrytëzojnë burime të ndryshme natyrore nuk guxojnë të pengojnë në shfrytëzimin e atyre rezurseve pa miratimin paraprak nga komuna e Kamenicës. Me funksionalizimin e biznesit sipas ligit për sponzorizim të sportit dhe artit biznesi do të përzgjedh një nga organizatat kulturore dhe sportive të

komunës së Kamenicës për sponzorizim dhe jo më pak se 20 mijë euro në vit. .Kompania **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"**, çdo vit dorëzon planin e financimit në DKRS, për mbështetjen e kulturës dhe sportit. Ndryshimi i destinimit të tokës komunale nuk mund të bëhet pa miratimin paraprak nga komuna e Kamenicës. Komuna miraton në tërësi projektin e veprimtarisë sipas planit të biznesit të këtij projekti gjatë periudhës të paraparë me planin dinamik dhe nuk mund të ndryshohet ose modifikohet veprimtaria e biznesit qoftë ajo edhe prodhimi i energjisë në forma të tjara si prodhimi i energjisë solare me erë etj, për shitje dhe distribuim për vetëm për nevoja të biznesit. Kontrata me kushte kushte specifike do të përpilohet dhe nënshkruhet pas aprovimit në kuvend komunal dhe pas aprovimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit qëndror përkatës.

**Ramadan Basha**-nga ajo që kam parë është një projekt i mirë, inovativ dhe po vazhdojë me besuar në krejt ata që janë paraparë, normalisht që edhe nëse e votojmë ky projekt do t'i nënshtrohet edhe disa fazave të marrjes edhe të një pëlqimi mjedisor që i përcakton efektet mjedisore dhe sa ka me pas impakt popullata lokale dhe ajo e përcakton edhe rrugëtimin se duhet të pajiset me leje apo jo dhe faza e fundit leja ndërtimore. Në rast se ne e cenojmë sot ne po e cenojmë Planin Zhvillimor Komunal, dhe besini që ministria këtë neve nuk na kalon për shkak se destinimi i tokës është për diçka tjetër në rast se e shohim destinimin e tokës është tokë bujqësore, rrugë, vendabnim, kullosë dhe varreza. Ndërsa, ne po dëshirojmë me aprovuar një kërkesë për një biznes, për deri sa kjo bie ndesh me PZHK-nsë, unë nuk e dij se si do ta akceptojë ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe jam i bindur se ata nuk e kalojnë. Kjo do të bëhet vetëm në rast se do të jetë investitor strategjik, por shuma e investimit nuk futet në kuptimin e investitorëve strategjik. Unë mendoj se edhe sikur ta votojmë ky projekt dhe ministria nuk e kalon.

**Rabit Dërmaku**-është një investim i mirë por marrja në shfrytëzim prej 35 viteve, energji e ripërtëritshme me hidrogjen prej mbeturinave që është në testim thujse në Evrop e Japoni sa kam pas mundësi me lexuar mendoj se nuk ka analizë financiare një investim 18 milion me një garancion bankar në vlerë prej 100 mijë euro mu smund të më bind ngase më duket jo serioz. Kam shikuar kompania ka 0 qarkullom bankar qe një vit është e regjistruar si biznes, plani i biznesit sa kam mujt unë me kuptuar ësht ëi pakompletuar, pa analizë financiare dhe pa analizë të rriskut. Kjo tokë është e parapamë si tokë bujqësore, këtu po vendoset për biznes mue smund mem bind me hidrogjen të pastër, ndryshimi nuk mund të bëhet pa e vendos komuna, ndryshimin a e bënë kuvendi apo ekzekutivi, fjalën e kam për ndryshimi i destinacionit të tokës ?

**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor-** kërkesat që kanë ardhur tani e dy vite në drejtori shumica kanë mbetur pa u trajtuar, shkaku i planit zhvillimor gjitha kërkesat e numrat e parcelave i kam dërguar tek grupi punës që kanë punuar në PZHK dhe i kam thënë që me i parapa ato që i vlerësoni se janë të mira për komunë mund të i parashihni në planin zhvillimor të ri. Sa i përket pyetjes së dytë është e vërtet se biznesi ka zero qarkullim se ky biznes është tani i regjistruar në Kosovë, përndryshe brenda planit të biznesit e keni se investimin e siguron një kompani tjetër një kompani e huaj që këta kanë bashkëpunim. Ndërrimi i destinimit të qëllimit të projektit normal që kanë me ardhën këtu se këtu u votua dhe në kuvend do të ndryshohet ngase çdo ndryshim që bëhet brenda ofertës të kontratës sjellët prapr në kuvend.

**Ramadan Basha**-me planin zhvillimor aktual, plani që është në fuqi kjo parcelë është e parapamë për diçka tjetër dhe destinimin e tokës ne nuk mundemi me ndërruar dhe destinimi i tokës bëhet përmes PZHK-së. Në planin zhvillimor të ri komunal i cili akoma nuk është i aprovuar dhe akoma nuk e ka marrë dritën jeshile prej ministrisë së mjedisit dhe

planifikimit hapësinor e infrastrukturës. A jeni e sigurt se në planin e ri parcelat respektive janë të destinuara për zhvillime biznesore, industriale e kështu me radhë. Nganjëherë edhe vullneti i juaj për me sjellë investitor nuk do të thot se çdo herë do të jetë i realizuar, por PZHK-ja e parandalon nës eme kohë nuk është bërë destinimi i saktë i tokës, çka është e parapamë në planin e ri zhvillimor kjo parcelë ?
**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor-** për planin e ri nuk kam informacione, por të paktën kur i kam kërkuar dokumentet në sektorin përkatës e kanë ditur se për cilin biznes po bëhet fjalë dhe na kanë lëshuar dokumentet.
**Rabit Dërmaku**-investiroti është një kompani tjetër që nuk ka emër këtu, ne po vootojmë një propozim-vendim mes një kompanie me këtë emër **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"**, dhe përfaqësuesit të asaj kompanie që ka nënshkruar me 0 të hyra dhe e regjistruar qe një vit. Nëse është ndonjë kompani tjetër do duhej të dalin emri i asaj kompanie.
**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor**-e thash edhe më herët se ndërmjetësues financiar i kësaj kompanie është "ALMS Kapital AG", një ndërmjetësues financiar ndërmjet tyre dhe përgjegjësi ne i kërkojmë kompanisë **"Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C"**, Adnan Hoxha, ngase ky e ka nënshkruar ofertën e negocimit së bashku me kryetarin.
**Florim Kryeziu**-unë nuk e dij se çfarë llogarie i kёkroni z. Adnan Hoxha me zero investime në llogarinë bankare. Ne kemi pasur shumë raste që u kemi dhënë toka dhe janë uzorpuar dhe nuk po punojnë asgjë, atyre që ju kanë dalë afati i kontratave bindni ti largojmë nga regjistri mos të jenë njerëzit e ngarkuar asnjëherë nuk po sjellën. Është mirë të dalin emri se nga cila kompani po mbështetet.
**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor-** kompania çdo 6 muaj e ka obligim me ardhën edhe me u përgjigj për ecurinë e planit të biznesit se si i ka shkuar, nëse gjashtë muaj deri një vit nuk ndërmerr asgjë komuna e ka të drejtën e shkëputjes së kontratës. Arsyeja pse është kështu është se ne kemi menduar se është mirë dhe me shtyrë përpara, kjo kërkesë është nga viti 2022 tash është në dorën tuaj nëse doni që kjo kërkesë me ecën përpara. Mënyra se si ai i siguron ai merr vet përgjegjësi.
**Rabit Dërmaku**-a je e bindur që me 18 milion investime 100 mijë euro garancion bankar është në rregull?
**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor**-është komisioni me vendim të kryetari që është themeluar për me i shqyrtuar këto kërkesa për prona, a më pëlqen mue a po jo unë mundë të shkoj e ti them kryetarit unë nuk hedh nënshkrim por janë personat që i negociojnë ofertat që vinë kërkesat për prona.
**Florim Kryeziu**- a jeni duke e shkelur ligjin pasi nuk është me planin zhvillimor komunal dhe e keni sjell një dokument që e shkelni ligjin.
**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor-** unë nuk jam duke e shkelur ligjin ngase nga sektorit përkatës i kam kërkuar dokumentat dhe është një grup që ka punuar në këto kërkesa.
**Florim Kryeziu**- je drejtoresh dhe përgjegjësinë pas kryetarit ti e ke dhe planin zhvillimor po e shkel këtë plan.
**Magbule Kastrati**-ju lus kryesues që shefi i gabinetit të largohet nga salla se nuk ka nevojë me u përzier në punën e delegatëve!
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës**, si shef i kabinetit ka të drejt të jetë prezent në mbledhje.
**Magbule Kastrati**- nëse nuk largohet shefi kabinetit nga salla ne do e lëshojmë mbledhjen.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës**-kërkojm nga shefi i kabinetit të rreshtohet nga ekzekutivi.

**Ramadan Basha**-unë nuk mundem të pres nga një kompani e huaj me ardhën me u ballafaquar me nxjerrjen e dokumentacioneve këtu. Me u ballafaquar me një kuvend komunal, kadastër, ministri etj, kjo kompani kryesisht do të merret me dokunentacione, pastaj kjo kompnai ose e ka të sigurt investitorin ose ka me gjetën një investitor, me një lloj forme këta kanë me u marrë vetëm me qështje të dokumentacionit dhe kjo është praktikë në Kosovë. Mos kërko me ardh një koorporatë ndërkombëtare e me na ardhën përfaqësues këtu me një farë forme ata nuk kanë kohë me u marrë me këtë punë. Mendoj që "**Ëaste to hydrogen Kosova L.L.C**", e kryejnë sidomos aspektin e dokumentacionit dhe marrjes së lejes ngase këta ose e kanë investitorin ose do ta gjejnë. Unë nuk kam problem në këtë sektor por problemi është në PZHK-në, urbanizmi e ka lëshuar një ekstrakt dhe pyetjen që ja kemi bërë urbanizmit se qka është e destinuar kjo tokë ata e tregojnë që është tokë bujqësore, varreza, rrugë, kullosë. Ky lloj i biznesit bie ndesh me PZHK-në, dhe jam i bindur që ministria nuk e kalon, kam përvojë në këtë fushë. A do duhej të pritej që të votohet PZHK-ja dhe mos me humb investitori, apo do duhejt të gjendet një lokacion tjetër i përshtatshëm ose tjetra a keni pyet në minstri se a kalon kjo apo jo apo duhet të votojmë një vendim që bi ndesh me PZHK-në. Në momentin që nuk është në përputhje me PZHK-në, ministria e mjedisit nuk lëshon pëlqim mjedisor.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-a e dëshiron dikush fjalën?
**Ramadan Basha**-votat abstenim ose kundër nuk duhet me i kuptuar që është kundër këtij projekti ose zhvillimit të Kamenicës, ndoshta do të ishte mirë që të ishte edhe kryetari e të na jep sqarime më të mira. Ne po pretendojmë që nuk është ligjore. Tek ekstrakti veëm të ishte zonë industriale, energjetike ne do e votonim të gjithë sot, ne nuk jemi kundër këtij projekti dhe kundër zhvillimit të Kamenicës, por jemi kundër procedurës për shkelje të Planit Zhvillimor Komunal që ministria nuk e kalon, prandaj kërkoj që të jetë për mbledhjen e ardhshme mos e hedhni në votim.
**Hasan Krasniqi**-këto që i thanë kolegët janë fakte që nuk mundemi mi anashkaluar, janë procedura që po shihen por jemi dëshmitar që PZHK-ja ka marrë shumë kohë dhe tani është vetëm kah fundi. Kërkesat për prona për biznese dhe për ndërtime janë kërkesa të mëdha, sa kam kuptuar nga ekzekutivi dhe çdo herë pengesa numër 1 po del PZHK-ja. A ka naj mundësi se si e ka menduar ekzekutivi deri të përfundoj PZHK-ja se edhe unë jam i sigurt se ky nuk mund të kalojë sa i përket destinacionit a është në plan apo jo për ndërtim nuk edij. Nëse ne si kuvend e kalojmë këtë pikë a bie ndesh diqka ekzekutivi nëse e kalojmë këtë pikë? Nryshe, si projekt vullneti i delegatëve është me kaluar.
**Jadranka Nikolic**-rasisht po merrem me parcela qe 15 vite të komunës së Kamenicës, të gjitha pronat që jepen për destinome të caktuara besoj shumë që janë jashtë planit zhvillimor komunal, ne nuk jemi kundër ndonjë ideje por jam e sigurt që nga ministria do të kthehet si vendim i pabazë jam i bindur që nuk do të kalojë ky propozim dhe që kam vërejtje që materialet për këto pika të rëndësishme po i marrin me vonesë.
**Labinot Skoverqani**-është mirë të shtyhet kjo pikë për seancën tjetër, ngase parcela është e destinuar për diçka tjetër, mendoj se të gjithë jemi për me pas sa më shumë investime në Kamenicë kjo prapë do të kthehet. Është mirë të kontaktohet MAPL-ja dhe me shikuar se si mund të marrim këtë vendim dhe mos të kthehet e jashtëligjshme.
**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor**-kjo kompani qe dy vite ka pasën interesim për investim në komunën tonë.
**Rabit Dërmaku**-pse e keni destinuar tokën që është kullosë dhe tokë bujqësore është duashur të propozohet tokën për ndërtim, biznes.

**Burbuqe Leka-Drejtoresh e Zhvillimit Ekonomik dhe Diaspor-** ata vet aty janë përcaktuar për atë tokë, ngase aty e kanë parë të përshtatshme për atë tokë.
**Ramadan Basha-**mendojë se nuk do të krijojmë figurë të mirë në rast se votojmë kundër këtij vendimi tek investitori por edhe tek investitori potencial, propozoj që kjo pikë të shtyhet të kontaktoni me MAPL-në, ministrinë e mjedisit dhe vazhdon procedura. Por nëse MAPL-ja, ky investitor ju garantoj që lejen mjedisore në ministri të mjedisist nuk mundet me marrën, leja mjedisore është kusht për me marrën leje ndërtimore, kur të sqaroheni në ministri në mbledhjen e ardhshme na jepni sqarimet se cili do të jetë qëndrimi i MAPL-së dhe i ministrisë së mjedisit dhe ne do ta kalojmë, ne jemi për me investuar dhe zhvilluar këtë komunë.
**Rabit Dërmaku-**nëse ka nevojë për këtë pikë edhe mbledhje të jashtëzakonshme do të vimë dhe do të votojmë, por me marrëveshje me MAPL-në dhe Ministrinë e Mjedisit.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-** propozojmë bashkërisht që që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe unë një draft-vendim do e dërgoj për konsultim paraprak MAPL-së që të njëjtin të na rekomandojnë se si të vazhdojmë tutje.
**Kush është që kjo pikë të shtyhet?**
**Për...........................17**
**Kundër ....................0**
**Absntenim................0**

**Me gjitha votat shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.**

## 4. Shqyrtimi i Raportit financiar Janar-Mars për vitin 2024

**Ardita Dërmaku- Drejtoresh për Financa dhe Buxhet**, para jush po paraqesim Raporti i tremujorit të parë buxhetor, ky raport është përgaditur bazuar në ligjin për menaxhimin e financave neni 45.2, 45.4 dhe 46.1. ky rpaort përfshinë të dhënat mbi arkëtimet dhe shpenzimet e buxhetit komunal gjatë kësaj periudhe. Sa i përket performancë së të hyrave si rezultat gjithsejt të hyrat vetanake të Komunës gjatë tremujorit të parë kanë shënuar shumën prej 152,139.17 € apo 40.35% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi ka qene kryesisht nga të hyrat: Tatimi në Pronë. Sa i përket performancë së shpenzimeve ato kanë arritur në 3,424.438.39 € përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024, apo 51.96% më shume krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë të njëjtës periudhë të vitit paraprak. Në shpenzime hynë shpenzimet për paga dhe mëditje ku gjatë këtij tremujori, shënuan vleren prej 3.130.294.03€ duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 34.86% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori per këtë periudhë. Krahasuar me vitin 2023 kanë shënuar një rritje prej 55.72%.Rritja ka rezultuar duke shpenzuar nga nenkodi ekonomik 11900 - Pagesa per vendime gjygjësore.Shpenzimet në mallra dhe shërbime kanë shënuar një rritje prej 9.80% krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars 2024 vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në 153.013.17 €, kjo shumë korrespondon me 6.72% të buxhetit të tërësishëm për këtë kategori .Shpenzime në komunali, kanë shënuar një rritje të prej 41.78% € krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaiperiudhe Janar-Mars 2024 vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në: 61.823.19 të buxhetit për këtë kategori.Shpenzimet në subvencione dhe transfere, shënuan rritje prej 33.40% € gjatë këtij tremujori, duke e arritur Kështu normën e ekzekutimit në 12.11% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë.
**Ramadan Basha-**kam vetëm një pyetje për investime kapitale.

**Ardita Dërmaku- Drejtoresh për Financa dhe Buxhet**-gjatë këtij tre mujori nuk kemi pasur pagesa për shpenzime kapitale.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,** nëse nuk keni diskutime të tjera, vazhdojmë me pikën e katërt.

5. **Propozim-vendim per dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankandit publik,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-kemi pikën e pestë siç dihet kërkesat tek drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka një numër të madh ëpr me marrë prona komunale në shfrytëzim, andaj zakonisht hasim dy–tri kërkesa për të njëjtën pronë dhe këto kërkesa i adresojmë përmes kuvendit që këtë pronë ta shtymë përmes ankandit publik, fjala ësht ëpër shfrytëzim afat shkurtër është fjala për zonën kadastrale në Poliqkë, vendi i quajtur " Kodra e Makovikëve", destinimi i kësaj prone është pronë bujqësore. Arsyet e kërkesës për marrjen në shfrytëzim është qëllimi i kultivimit të kulturave bujqësore, kohëzgjatja e kërkesave në drejtim kanë qenë deri në pesë vjet, andaj si kuvend kërkojmë që të ja mundësojmë të njëjtat prona të dalin në ankand dhe të gjithë të interesuarit të kenë të drejta të barabarta për me aplikuar dhe e i marrë pronën në shfrytëzim.
A e dëshiron dikush fjalën, nëse jo e hedhim në votim këtë propozim-vendim, **kush është për miratimin e kësaj pike?**
**Për..........................16**
**Kundër ...................0**
**Absntenim...............0**

6. **Propozim-vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankandit publik,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,**secila pronë që shkon përmes ankandit do të ketë edhe komisionin vlerësues, komisioni përbehet nga 5 anëtarë 2 nga ekzekutivi, 1 nga shoqëria civiel dhe 2 nga legjislativi. Vazzhdojmë me propozime nga kuvendi:

1. **LVV propozon Lirim Kryeziun**
2. **PDK propozon Rabit Dërmakun,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës,** kush është për këtë pikë të rendit të ditës?
**Për.......................... të gjithë.**
**Kundër ...................0**
**Absntenim...............0**

7. **Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024,**

**Ardita Dërmaku- Drejtoresh për Financa dhe Buxhet**-bazuar në ligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës Ligji Nr. 08L/260 për vitin 2024, neni 9 dhe ndarja e fondeve të bartuna si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak pika 7. Të hyrat

vetanake të realizuar gjatë vitit 2023 dhe të regjistruara në sistemin SMFK, kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1, për vitin 2023 por të vitit 2024 me vendim të kuvendit komunal. Me këtë propozohet bartja e mjeteve nga të hyrat vetnake nga viti 2023 në vitin 2024 bazuar nga neni 9 pika e 7 e ligjit 08L250 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 në shumën totale prej 256 mijë 526.89 €. Ndarja propozohet në këtë mënyrë në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma prej 256 mijë 526.89 €, zyra e kryetarit, participimi me donatorë 99 mijë 785.79€, infrastruktura publike shuma prej 1,760.93, ndërtimi i pritoreve të autobusëve Hogosht, Shipashnicë të Poshtme, Topanicë, Koretin, Kopërnicë dhe Petroc si dhe planifikimi Urban dhe Inspekcioni shuma prej 154,980.27 €. Ku i keni të specifikuara rend Asfaltimi i rrugëve në Hodonoc shuma prej 50 mijë euro, në fshatin Petrovc shuma prej 18,816.53€, Shipashnicë e Ulët shuma prej 6,647.00€, etj në material i keni të specifikuara nëse keni pyetje unë jam këtu.
**Florim Kryeziu**-prej shumës 256 mijë euro a ka mjete të lira dhe pyetja e dytë është tek pritoret që e ka marrë komuna përsipër me i ndërtuar, sipas meje dhe sipas ligjit këto shkojnë me ministri të infrastrukturës edhe pritoret edhe vendi është që shkojnë me infrastrukturë a keni memorandum bashkëpunimi me ministrinë e infrastrukturës?
**Ardita Dërmaku- Drejtoresh për Financa dhe Buxhet**-sa i përket pyetjes së parë që e thatë se a ka tepricë të këtyre mjeteve gjitha i kemi specifikuar me shuma dhe shifra të sakta të gjtiha janë të zanuna në bazë të obligimeve dhe kontratave që i kemi. Ndërsa pyetja e dytë tek projekti ndërtimi i pritoreve është projekt komunal dhe nuk kemi ndonjë marrëveshje me ministrinë e infrastrukturës do të thotë është projekt i komunës.
**Florim Kryeziu**- po flas nga përvoja se ne kemi pasur edhe në Roganë dhe tani e kemi kërkesën në komunë, komuna thotë se duhet të merret leje për një memorial se është e infrasttrukturës, do të thotë komuna nuk merr leje nga ministria për pritore, ndërsa ne qytetarë duhet të marrim leje në ministri të infrastrukturës.
**Ardita Dërmaku- Drejtoresh për Financa dhe Buxhet**- ne para aprovimit të buxhetit non stop konsultohemi edhe me ministrinë e financave dhe nuk kemi pasur ndonjë ankesë për ndryshim.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-nëse nuk ka pyetje të tjera vazhdojmë me procedurë të votitmi, kush është për miratimin e pikës së 7-të?
**Për..........................18**
**Kundër ...................0**
**Absntenim...............0**

8. **Propozim-vendim për caktimin e lokacionit në pronën e paluajtshme të Komunës së Kamenicës për ndërtimin e Strehimorës për Qent endacak,**

**Shpend Morina-Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**, ky është një projekt në bashkëpunim me MAPL-në e cila ka shprehur gadishmërinë për financimin e strehimoreve pothuajse në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Neve si komunë kanë kërkuar të caktojmë një lokacion, ne si drejtori kemi parashtruar kërkesën në drejtorin e kadastrit në bashkëpunim me drejtorin e urbanizmit për ti ndjekur procedurat që duhet ndjekur për caktimin e këtij lokacioni. Ka kritere specifike për caktimin e lokacionit është ligji i veterinës, mirëpo shumë më tepër është udhëzimi Administrativ 2023 është udhëzim administrativ për kushtet teknike për ndërtimin e një strehimore kafshët shoqëruese në këtë rast qent endacak. Si kriter që është duhet të jetë minimumi 500 m, larg vendbanimeve dhe parcela në fjalë është mbi 700 m, që i plotëson kriteret. Është e përshtatshme për shkak që rruga

asfaltin nuk e ka larg dhe përshtatën nëse kalon dhe implementohet si projekt, mund të vazhdohet pjesa tjetër me rrugë në zhavorr për tu qasën në rrugë kryesore, këto janë disa kritere bazike.

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**-parcela gjendet në Topanicë, vendi i quajtur " Shirinë", dhe i plotëson të gjitha kriteret për strehimin e qenve

**Shpend Morina-Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**- është tokë bujqësore e klasit të 5-të e cilësisë së dobët dhe i plotëson edhe kriteret ligjore dhe teknike për procedim më tutje.

**Rabit Dërmaku**-dua të dijë kohën se sa do të zgjatë deri në realizimin e këtij projekti?

**Shpend Morina-Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**-fillimisht ajo që është kërkaur nga MAPL dhe gëzon edhe një lloj përgjegjësie edhe niveli qendror sa më shpejt se në përgjithësi në të gjitha komunat tek qytetarët është identifikuar si problemi kryesor qent endacak. Është një problem emergjent me vite që diskutohet, përveç kësaj ne si drejtori e kemi filluar edhe një projekt nga java e kaluar që ka filluar me u implementuar është një projekt për trajtimin e qenve endacak. Ky projekt është trajtimi i qenve, fillimisht kapja, vlerësimi i gjendjes shëndetësore, pastaj krastimi dhe kthimi në vendin ku është kapur. Kjo në afat të shkurtër nuk mundet të japë një rezultat, mirëpo në afat të gjatë do të japë rezultat se do të ndaloj shtimin e tyre dhe do të ulë agresivitetin e qenve endacak, mirëpo ne e dimë se kjo nuk është e vetmj zgjidhje dhe kemi vazhduar edhe me projektin, nuk muj të jap një kohë të caktuar se kur do të filloj por ne si procedurat jemi duke i ndjekur me ministrinë jemi takuar dhe gadishmëria është që këto punë sa më shpejt të ecin përpara.

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës**- thuajse në gjitha komunat e Kosovës është si pikë e rendit të ditës.

**Rabit Dërmaku**-qent që kafshojnë ndonjë qytetar minimuni e ka një kosto 150 euro harxhime vetëm për atë kafshim. Po ashtu nuk dihet ngase qent nuk janë të vaksionuar se do të infektohet ai pacient me rabis.

**Shpend Morina-Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**- në këtë projektin komunal që e përmenda që shkon në kuadër të drejtoorisë së bujqësisë në kuadër të shërbimeve nuk do të munden të mbulohen të gjitha zonat, por fokusi do të jetë në qytet dhe në fshatrat, shkollat, ambulancat dhe vendet ku ka frekuentim, kryesisht fëmijë dhe qytetarëve në përgjithësi.

**Ramadan Basha**-unë po e vlerësoj shumë që komuna e Kamenicës me pasën një strehimore për qen dhe për shkak të problemeve të kahmotshme dhe të vazhdueshme që po na shkaktojnë neve qytetarëve të komunës tonë. Atë që e ngriti doktor Rabiti është thjesht një lloj dëshire, por edhe një nevojë që edhe drejtori i bujqësisë me qenë sa më ekspeditiv, sa më këmbëngulës pas këtij vendimi me ministrinë me ministrinë përkatëse të fillojnë edhe provedurat tjera në kuptimin që edhe strehimorja me u bërë sa më shpejt për shkak se është një kërkesë urgjente, përndryshe me kënaqësi do e votojmë këtë vendim.

**Florim Kryeziu**-komuna a e ka obligim vetëm pronën me ja dhënë ministrisë apo edhe investimet në aspektin e infrastrukturës ?

**Shpend Morina-Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**- Ky projekt përfshinë krejt territorin e Kosovës, por kanë kërkuar nga komunat caktimin e lokacionit, mirëpo financimin e objektit e bënë ministria dhe sigurisht në fazat e mëtutjeshme duhet me ju dhënë ndonjë operatori ekonomik, ndonjë ordinance veterinere që ka kritere specifike ngase komuna nuk ka profile që mund të mirëmbajt vetë. Por, financimi do të jetë nga Ministria se do të ketë një kosto të lart dhe për komunën është e papërballueshme ky investim.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-nëse nuk ka diskutime të tjera e hedhim në votim,
Kush është për miratimin e kësaj pike?
Për...........................18
Kundër ....................0
Absntenim................0

9. Propozim për plotësim ndryshimin e vendimit nr.15617 i datës:08.06.2021

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- ky vendim është vendim mbi listën e panelit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komiteit Konsultativ për personat me nevoja të veçanta, në këtë komitet i cili përbëhet nga 7 anëtarë, njëra nga anëtarët Xhejlane Dauti, nga ky komitet për Personat me Nevoja të Veçanta ka kërkuar që të largohet nga ky komitet për arsye personale, nëse nuk ka diskutime a e hedhim në votim,
Kush është për miratimin e kësaj pike?
Për...........................me të gjtiha votat, gjithsejt 16 të pranishëm
Kundër ....................0
Absntenim................0

10. Propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes ankandit publik,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-me këtë propozim-vendim propozohet dhënja në shfrytëzim e pronës e paluajtshme të komunës, kjo pronë gjendet tek qendra tregtare me një sipërfaqe prej 6208$m^2$, mirëpo parcela që synohet të jepet në shfrytëzim ka gjithsej 85 $m^2$, është pronë e komunës së Kamenicës, a e dëshiron dikush fjalën, nëse jo e hedhim në votim pikën e rendit të ditës.
Kush është për miratimin e pikës së 10-të?
Për...........................me gjitha votat gjithsejt 16 të pranishëm
Kundër ....................0
Absntenim................0

11. Propozim-Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzom përmes ankandit publik,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- edhe këtë propozim vendim duhet të plotësohet me dy anëtarë nga kuvendi.

1. LVV propozon Hasan Krasniqi
2. PDK propozon Florim Kryeziu

Kush është për miratimin e pikës së 11-të?
Për...........................16
Kundër ....................0
Absntenim................0

12. Propozim-vendim për hartimin e hartës zonale të komunës së Kamenicës,

**Uran Berisha- Drejtor i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,** ne kemi dërguar një propozim-vendim te kryetari për fillimin e procedurave për hartimin e hartave zonale, harta zonale është hapi i radhës pas hartimit të PZHK-së. Ne pasi vizituam ministrinë kemi marrë sqarime na treguan se pse nuk ka përfunduar PZHK-ja, mundeni me filluar edhe hartën zonale dhe kjo është arsyeja që ka ardhën jashtë rendit të ditës. Harta zonale është nivel tjetër i planifikimit për ata mos me qenë të informuar, nivel më i detajizuar i dokumenteve të planifikimit hapësinor për derisa PZHK_ja merret me destinim të sipërfaqeve HZK-ja merret me detalizim të kushteve ndërtimore. Shembull nëse PZHK-ja e thotë se kjo është zonë ndërtimore, HZK-ja e thotë se kjo zonë ndërtimore për objekte të larta deri në sa kate të larta ose të ulëta.
**Ramadan Basha**-si e keni menduar punë rreth hartave zonale, kush ka me bërë a mendoni hartat me i bërë me zyrtarët e komunës apo në qfar forme.
**Uran Berisha- Drejtor i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor**-kemi kontraktuar përmes procedurave të prokurimit ekspert nga jashtë të cilët kanë me vazhduar detalizimin e PZHK_së i cili është ende në ministri dhe nuk na kanë kthyer përgjigjen se a kalon apo ka nevojë për revidim, privatisht na kanë thënë se do të kthehet me nevoja për revidim, ndërsa të njëjtit do të vazhdojnë edhe me HZK-në.
**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal,** a keni diskutime të tjera, nëse jo vazgdojmë me procedurë të votimit,
**Kush është për miratimin e pikës së 12-të?**
**Për.........................me gjitha votat gjithsejt 18 të pranishëm**
**Kundër ...................0**
**Absntenim...............0**

## 13. Të ndryshme

**Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal,** a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 11:30

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtës** | **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës** |
| Sabile Arifi | Liridon Kastrati |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYT...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. Nr. 01 Br. 12605
Nr. i fq. Br. str. 20 Data Datum: 19/04 2024
KAMENICË/A

**DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**
**NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

| | | |
|---|---|---|
| **DATA** | 19/04/2024 | Nr. i protokolit 381/24 |
| **PËR** | **Liridon Kastrati**, Kryesues i Kuvendit Komunal, Kamenicë | |
| **PËRMES** | **Qendrës për Shërbime me Qytetarë** | |
| **NGA** | **Nazmije Demolli-Kastrati**, Kryesuese e Komitetit Lokal Veprues bazuar në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026 në Komunën e Kamenicës | |
| **LËNDA** | Kërkesë | |

I nderuari z.Kastrati,

Ju njoftoj që Plani i Veprimit Lokal sipas Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026 në Komunën e Kamenicës, i ka kaluar procedurat ligjore duke filluar nga formimi i komisionit, grupit punues si dhe mbajtjes së diskutimit publik me qytetarë.

Andaj, në cilësinë e Kryesueses e këtij Komitetit Lokal Veprues, kërkojmë nga JU që ta procedoni këtë plan të veprimit në Kuvend.

# Plani i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali 2024 - 2026 në Komunën e Kamenicës

Prill
2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIME TË QY
CENTAR ZA USLUGE GRAĐANA
Sh. 02 Nr. 38270
Br.
Nr. i faq. 1 Data 14/11
Br. str. Datum 2023
KAMENICA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02 nr.383 – 13.11.2023.**

Në bazë të dispoztave të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 70 shkronja 6) të Statutit Sh.01 Nr.20203 të datës 21.06.2023, neni 50 paragrafi 1 të ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Pergjithshme Administrative si dhe vendimit bazë Sh.02 nr.6015 i datës 23.02.2023, Kryetari i Komunës më 13.11.2023 nxjerrë këtë:

**VENDIM**

**Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.02 Nr.6015 i datës 23.02.2023 për formimin Komitetit Komunal Veprues (KKV)**

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika (1), paragrafi 1.1 e Vendimit bazë Sh.02 Nr.6015 i datës 23.02.2023 për formimin e Komitetit Komunal Veprues bazuar sipas Strategjisë së re për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali.
Paragrafi (1.1) një pikë një i vendimit bazë ndryshohet dhe ate: Z.Afrim Dervishi anëtarë i KKV, zevendesohet me Znj. Nazmije Demolli anëtare e KKV-s.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

3. Ky vendim është pjesë përbërse e vendimit baze bazë Sh.02 Nr.6015 i datës 23.02.2023 për formimin e Komitetit Komunal Veprues.

4. Vendimit i bashkangjitet kopja e Vendimit Bazë bazë Sh.02 Nr.6015 i datës 23.02.2023 për formimin e Komitetit Komunal Veprues.

*Vendimi t'u dërgohet:*
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës per Informim;
- Afrim Dërvishi
- Nazmije Demolli dhe
QSHQ - arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 6015
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 23/02
KAMENICË/A 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINA KAMENICA MUNICIPALITY OF KAMENICA

Nr.59
Datë: 23.02.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 78 nën b) të Statutit Sh01 Nr.005.2008 të datës 26.09.2008 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit Sh01.Nr.15/2010 të datës 31.02.2010 të Komunës së Kamenicës, Shkresën Nr 0-43 të datës 16.01.2023 nga MAPL, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. FORMOHET Komiteti Komunal Veprues bazuar sipas Strategjisë së re për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, me këtë përbërje:

   1.1. Afrim Dërvishi, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim
   1.2. Furona Hoda, Drejtoria për Shëndetësi Mirëqenie Sociale
   1.3. Bajrush Kriezi, Zyrtar në ZLK
   1.4. Teuta Kastrati, Zyrtare Komunale për barazi gjinore, lidhja dhe riatdhesim,
   1.5. Selami Zylfiu, Drejtoria për Financa dhe Buxhet
   1.6. Alban Hashani, Zyrtar për Bartin
   1.7. Sherafedin Vranja, (shoqëria Civile)
   1.8. Besa Tusha, (shoqëria Civile)
   1.9. Lavdim Klaiqi, (shoqëria Civile)

2. Komiteti Komunal Veprues do të udhëhiqet nga Kryetari ose Nënkryetari i Komunës, me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së Komitetit Komunal veprues.

3. Komiteti i formuar me pikën (1) një të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e Planit Lokal të Veprimit (PLV) dhe ndryshimi periodik i tij nëse lind nevoja. Në zhvillimin dhe ndryshimin e PLV-së, KKV-ja do të sigurojë bashkërendimin ndërmjet palëve të ndryshme të interesit dhe qasjen e të gjithë hisedarëve.

4. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është komisioni i formuar si në pikën (1) një të këtij vendimi.

5. Komisioni për punën e vetë i raporton Kryetarit të Komunës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:
- Zyres së Kryetarit;
- Anëtarëve të Komisionit dhe
- Q SH Q - arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri RAHIMAJ

Përmbajtja

Lista e shkurtesave........................................................................................................................

Përmbledhje ekzekutive ..................................................................................................................

1.Hyrje ...............................................................................................................................................

2.Metodologjia ...................................................................................................................................

3.Analiza e gjendjes...........................................................................................................................

3.1. Arsimi ...........................................................................................................................................

3.2 Punësimi dhe Mirëqenia Sociale ..................................................................................................

3.3 Shëndetësia ...................................................................................................................................

